

VENDIM
Nr. 623, datë 30.7.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIM I RRUGËS ELBASAN–PËRRENJAS – QAFËTHANË, FAZA VIII”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerim i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë, faza VIII”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 32 491 879.7 (tridhjetë e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 32 491 879.7 (tridhjetë e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.
8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË, FAZA VIII”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim						Vlera totale	Sbënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Vlerësimet për shpronësim sipas llojit “truall”			Vlerësimet për objektet e banimit			Preventiv	
										Sip. (m ²)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. (m ²)	Cmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Shkelqim	Hajdar	Cepi	Vulçan	Librazhd	3843	396-ND1	Ndërtesë	116.8				116.8	32,695.0	3,818,776.0		3,818,776.0
	Donika	Hajredin	Cepi														
2	Alma	Beqir	Sina	Vehçan	Librazhd	3725	267/7-ND3	Ndërtesë	165				405.5	32,695.0	13,257,822.5	6,050,427.0	19,308,249.5
	Eduart	Selim	Sina														
3	Ismet	Xhaferri	Stafa	Vulçan	Librazhd	3843	397/3	Truall	261.3	261.3	154.0	40,240.2	139.9	32,695.0	4,574,030.5		4,614,270.7
	Trandafille	Isak	Stafa														
4	Dashamir	Hajdar	Cepi	Vulçan	Librazhd	3843	396-ND	Ndërtesë	145.3				145.3	32,695.0	4,750,583.5		4,750,583.5
	Bakarije	Hajdar	Kryemadhi														
	Antoneta	Hajdar	Xoxa														
	Shkelqim	Hajdar	Cepi														
	Luljeta	Hajdar	Hoxha														
VLERAT TOTALE																32,491,879.7	